



Pranuar / Dorezuar Primjenof/Prodato Received/Delivery	25-08-2022	2	viti god year
Organ/Njësia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKM/MBIK	4978/2022		1/4



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.597/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtare, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, sipas Aktgjykimit A.nr.1932/2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.597/2021 të datës 29.06.2021, të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi: kundër organit të punësimit Policisë së Kosovës në çështjen juridike "Kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 25.08.2022, mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shpallet **jo kompetent** për të vendosur për ankesën me numër A.nr.597/2021 të datës 29.06.2021, të parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi sipas kontratës së punës të datës 23.07.2011 i punësuar në Policinë e Kosovës, në pozitën "Pastrues", në Drejtorinë Regjionale të Gjilanit, në Policinë e Kosovës, me datë 19.04.2021 ka parashtruar kërkesë për kompensimin e shtesave të përcaktuara në Udhëzimin Administrativ Nr.02/2018 të datës 14.11.2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, ndërsa Drejtoria e Personelit me datë 05.05.2021 i ka kthyer përgjigje përfaqësueses ligjore të ankuesit duke ia refuzuar kërkesën e tij të datës 19.04.2021.

Ankuesi i pa kënaqur me përgjigjen e datës 05.05.2021 të Drejtorisë së Personelit, ka parashtruar ankesë me datë 21.05.2021 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Policisë së Kosovës.

Ankuesi për shkak të heshtjes administrative të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave, me datë 29.06.2021 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për kompensimin e pagesës për shujtën ditore si dhe pagën e 13-të në mënyre retroaktive për vitet 2018, 2019 dhe 2020 sipas, sipas Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, të datës 14.11.2018.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave me datë 30.06.2021 ka nxjerr vendimin me shifër: 703-KA-2021 duke e shpall veten jo kompetentë me arsyetimin se ankuesi e ka statusin e nëpunësit administrativ dhe mbështetës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 02.07.2021, ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Policia e Kosovës. Më datë 13.07.2021 ka përcjell gjithë dokumentacionin lidhur me këtë lëndë 1/20.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga data 30.06.2021 ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankuesit, ndërsa më datë 12.08.2021, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka njoftuar ankuesin për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës duke udhëzuar që mund të ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesi, ka ndjekur procedurat e tjera administrative duke iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative më datë 14.07.2022 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.1932/2021 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 12.08.2021 duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e ankuesit të datës 29.06.2021.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritator ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës me numër protokollit 3335/2021 e datës 29.06.2021 me shkresat e bashkangjitura 1/8; Autorizimin e përfaqësuesit ligjor të palës i datës 14.04.2021; Vërtetimin e punësimit të ankuesit të datës 12.04.2021; Kërkesën e ankuesit të datës 19.04.2021; Përgjigja e Drejtorisë së personelit të Kosovës e datës 05.05.2021; Ankesën e ankuesit të parashtruar në komisionin e Ankesave të Policisë së Kosovës e datës 20.05.2021; Autorizimin e datës 28.06.2021; Kërkesa për përgjigje në ankesë të datës 02.07.2021; Përgjigja në kërkesë e datës 13.07.2021; Kontratën e punës së ankuesit të datës 20.11.2003; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën pastrues në Policinë e Kosovës; Vendimin e Komisionit të Ankesave të Policisë së Kosovës të datës 30.06.2022, Aktgjykimin A.nr.1932/2021 e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative të datës 14.07.2022, Njoftimin e Këshillit të datës 12.08.2021.



Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës konstatohet se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nuk është kompetent për të vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesi *se pse:*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në provat e lëndës, respektivisht Kontratën e punës me numër reference: 07/1-01A/0665 për kohë të pacaktuar të datës 20.11.2003 të ankuesit, ka konstatuar se ankuesi mban pozitën e punës "Pastrues" në kuadër të Policisë së Kosovës-Drejtorinë Regjionale të Gjilanit/Divizioni i Sigurisë Publike dhe i njëjti sipas kontratës së punës kryen këto detyra të punës: "Bënë mirëmbajtjen dhe pastrimin e vazhdueshëm të të gjitha hapësirave administrative, korridoreve dhe të gjitha hapësirave tjera në kuadër Stacioni. Bënë grumbullimin e mbeturinave dhe largimin e tyre deri në vendin e caktuar - deponi të mbeturinave..... Kujdeset që të gjitha zyrat të jenë të pastra sipas planit të punës të përcaktuar nga mbikëqyrësi.....".

Lidhur me pranueshmërinë e ankesës, Kolegji ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht neni 2 ku përcaktohet se: 3. *Nëpunës civil - është zyrtari publik në kuadër të Shërbimit Civil, i cili ushtron detyrën në një pozitë, duke filluar nga zyrtari profesional deri në pozitën e sekretarit të përgjithshëm në administratën e Presidentit, në administratën e Kuvendit, në Zyrën e Kryeministrit, në ministri, në agjenci ekzekutive, në agjenci dhe në një degë lokale të tyre, në administratën e institucioneve të sistemit të drejtësisë, në institucion të pavarur, në agjenci të pavarur, në administratën komunale dhe çdo nëpunës i përcaktuar drejtpërdrejt me ligj të veçantë: 6. Nëpunës administrativo-teknik - dhe mbështetës është zyrtari publik, që kryen veprimtari ndihmëse, të mirëmbajtjes, ruajtjes, vozitjes, si dhe veprimtari të tjera të ngjashme në institucionet e administratës publike" dhe si rrjedhojë duke u bazuar në përshkrimin e detyrave të punës të ankuesit, Kolegji ka konstatuar se pozita "pastrues" hynë në kategorinë e nëpunësve administrativo-teknik dhe mbështetës respektivisht ankuesi nuk ka statusin e nëpunësit të shërbimit civil.*

Andaj, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesat e nëpunësve civilë dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin Civil si dhe duke marr parasysh konstatimin se ankuesi ka statusin e nëpunësit administrativo-teknik dhe mbështetës, Kolegji konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.597/2021 e datës 29.06.2021 të parashtruar nga ankuesi

Kolegji për Shqyrtimin dhe e Ankesave, bazuar në nenin 82 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ka konstatuar se marrëdhënia e punës e nëpunësit administrativ dhe mbështetës i nënshtrohet legjislacionit të punës, dhe sipas 24 paragrafi 4 të këtij ligji, zyrtarët publik me status të nëpunësve administrativo-teknik dhe mbështetës kanë të drejtë të ankohen te punëdhënësi dhe më pas mund të fillojnë kontest administrativ në gjykatën kompetente.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.597/2021

Flakron GASHI

Zyrtare i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit,
- Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Policinë e Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së.